



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 326/6 Prot.

Tiranë, më 10.09.2024

**V E N D I M**

**Nr. 49, datë 10.09.2024**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË  
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONIN BASHKIA VLORË  
DHE PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË MBIKËQYRJES**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me situatën e administrimit të shërbimit civil, në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Vlorë,

**VËREJ SE:**

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 59 (326 prot.), datë 22.05.2024, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të plotësimin të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Vlorë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar mbikëqyrjen e përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, sipas kërkesave të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Vlorë.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 326/1 Prot., datë 22.05.2024, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar institucionit me shkresën nr. 326/2 Prot., datë 22.05.2024, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Vlorë”.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Mënyra e administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Vlorë, si njësi e qeverisjes vendore, bazohet në nenin 2, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ku është parashikuar në mënyrë të shprehur se, *“fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore”*.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, nga ku ka rezultuar se, në institucionin e mbikëqyrur, njësia e burimeve njerëzore, gjatë realizimit të procedurave administrative për ato institute të ligjit objekt të mbikëqyrjes, të cilat janë analizuar në material, ka ushtruar funksionin e saj në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar. Shembuj të ushtrimit të këtij funksioni janë zhvillimi i proceseve të tilla si, hartimi i përkrahjeve të punës; procedurat e konkurrimit për plotësimin e vendeve të lira në të gjitha nivelet, apo procedurat e ristrukturimit, ku njësia e burimeve njerëzore, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, është struktura që drejton gjithë procesin nga pikëpamja ligjore e zbatimit të procedurave.

Projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr.326/4/3 prot., datë 26.07.2024, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në lidhje me mbikëqyrjen e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil në institucionin, Bashkia Vlorë”*, duke i lënë një afat 5 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me materialin, nëpërmjet shkresës nr. 11937/1 prot., datë 02.08.2024, *“Dërgohet projektraporti i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe nëpunësi i ngarkuar me detyra të administrimit të shërbimit civil”*, ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, pa vërejtje.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me konstatimet e evidentuara.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, dhe rezultoi se nuk janë konstatuar parregullsi në administrimin e shërbimit civil, atëherë procesi i mbikëqyrjes do të përmbyllet pa vendim paralajmërimi.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar,

### **V E N D O S A:**

1. Të miratoj raportin përfundimtar, në lidhje me mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Vlorë, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe përfundimin e procesit të mbikëqyrjes pa vendim paralajmërimi, në kushtet kur nuk janë konstatuar parregullsi gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil.
2. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Vlorë, Prefekti i Qarkut Vlorë, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjensia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**